



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/111

Datë: 25.06.2026

Në bazë të nenit 49 të Ligjit të punës Nr. L/-212 dhe Udhëzimeve Administrative Nr. 07/2014, Nr. 401/2015, për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave administrative të pagesave financiare për pushimin e lehonisë, nenit 58 paragrafi (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); nenit 42 paragrafi (i) dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, si dhe kërkesës me numër të protokollit 8-155/4393 të datës 25.06.2026 nga znj. Fitesa Berisha Gacaferi, Kryetari i Komunës me datë 25.06.2026 nxjerrë këtë:

V E N D I M

për lejimin e pushimit të lehonisë

znj. Fitesa Berisha Gacaferi, e sistemuar në vendin e punës Infermiere e përgjithshme mbështetëse në QKMF dhe ka kontratë valide në kohë të caktuar.

znj. Fitesa Berisha Gacaferi, i lejohet pushimi i lehonisë me kohëzgjatje prej 6 muajve duke filluar prej 22.06.2026 deri më 21.12.2026 me mundësi vazhdimi.

Gjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë, paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës bazë të nëpunëses.

Tre (3) muajt në vijim, paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë.

Tre (3) muaj e tjerë, pa pagesë mund të merren me kërkesën e nëpunëses publike.

A r s y e t i m

Në përputhje me nenin 49 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212 e në mbështetje të Udhëzimeve Administrative Nr. 07/2014 dhe Nr. 401/2015, për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave administrative të pagesave financiare për Pushimin e lehonisë si dhe dokumentacionit mjekësor të ofruar nga znj. Fitesa Berisha Gacaferi, vërtetohet se e njëjta ka lindur me datën 22.06.2026, andaj të njëjtës i lejohet Pushimi i lehonisë siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet:

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
- Pala e referuar;
- Zyra e personelit;
- Arkivi.

